



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1017/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “REXHA” SH.P.K., me NUI:810515223, me seli në rrugën “Kroi i Bardhë” Llamella A, Lokali 107, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.F., avokat në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në rrugën “UCK-2”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.H., avokate në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.256/21 të datës 30.07.2021, të Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli, me seli në Ferizaj, pas mbajtjes së 17.08.2023 jashtë seancës, me datë 29.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.256/21 i datës 30.07.2021, i Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “REXHA” SH.P.K., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.256/21 të datës 30.07.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.14-210-001-21 e datës 29.06.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 453,220.20 €, me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e përmbartimit nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, në të kundërtën përmbartimi të ekzekutohet me bllokimin e llogarive të debitorit në të gjitha Bankat Komerciale në Kosovë dhe me bartjen e mjeteve në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të pasurisë së debitorit deri në pagimin e borxhit të tij.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka në të cilin ka theksuar se urdhri përmbartimor është i pabazuar, i palejuar dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, për faktin se fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi nuk paraqet dokument përmbartues, në faturë mungon pranimi i punimeve nga autoriteti kontraktues sepse në rastin konkret nuk ka ekzistuar asnjë situacion i pranuar për punët kontraktuese pasi që punët ende nuk kishin filluar, në faturë nuk paraqitet as afati i pagesës, as përshkrimi i shërbimit të kryer, dhe e njëjta është në kundërshtim me nenin 29 të LPP-së. Ka shtuar se, fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi nuk përmban as elementet e detyrueshme siç kërkohen me nenin 22 të Rregullës Financiare nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parasë Publike dhe në kundërshtim me nenin 20 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, të datës 19.12.2010, të nxjerrë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Kosovës, me të cilën është paraparë se çka duhet të përmbaj një faturë. Ka theksuar se, fatura është lëshuar për Situacionin I – për dëmet e shkaktuara për mos fillimin e punimeve nga ana e AK-Komuna e Prishtinës, mirëpo në Kontratën bazë nuk parashihet situacion i shërbimeve për mos punë, andaj fatura është fiktive dhe e kundërligjshme. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet prapësimi i debitorit, të shfuqizohet Urdhri Përmbartimor P.nr.256/2021 i datës 30.07.2021, të refuzohet si i pabazuar propozimi për përmbartim i kreditorit si dhe të obligohet kreditori që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës përmbartimore për përpilimin e prapësimit në shumën prej 1,350.00 €.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilin ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar se urdhri përmbartimor është i bazuar në dispozitat e LPP-së. Tutje ka shtuar se, sa i përket përshkrimit të faturës e njëjta i referohet shërbimeve dhe punëve të kryera në Tregun e Qytetit sipas Kontratës me numër të prokurimit Nr.616-19-9686-5-1-1/C550 të nënshkruar me Autoritetin Kontraktues. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa Urdhri Përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbartimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 1,300.00 €.

Gjykata lidhur me këtë çështje ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore me datë 17.08.2023, në të cilën seancë kanë qenë të pranishëm përfaqësuesi i kreditorit dhe debitorit.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se, urdhri përbarimor është lëshuar në përputhje me kontratën e lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit, përkatësisht me lëndën e kontratës - Ekzekutimi i punëve në tregun e ri të qytetit, e cila kontratë pa fajin e kreditorit nuk ka mund të fillohej të zbatohet sipas afatit të paraparë dhe duke u bazuar në nenin 30 të kontratës e cila ka paraparë se nëse autoriteti kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë në vend ndërtim, konsiderohet si shkak për kompensim, nisur nga ky shkak kreditori i ka dërguar debitorit faturën dhe situacionin për dëmet e shkaktuara për shkak të moszbatimit të kontratës, të njëjtën e ka pranuar debitori dhe nuk i është përgjigjur kërkesës për pagesë.

Përfaqësuesi i debitorit gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se, fatura e cila është objekt i kësaj procedure përbarimore nuk paraqet dokument të përshtatshëm përbarimor, për arsye se e njëjta nuk është e nënshkruar nga debitori në vendin ku duhet të nënshkruhet, si dhe shuma e kërkuar me faturë nuk është certifikuar nga menaxheri i kontratës, siç është paraparë me kontratën bazike sipas së cilës kreditori do të duhej të dorëzonte faturat e nënshkruara dhe të vulosura tek sportelet e debitorit. Në fund ka theksuar se nuk është dorëzuar asnjë dëshmi nga kreditori për punët e kryera.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, deklarimeve gjatë seancës dëgjimore, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.1 nën par. 1.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen: *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata vlerëson se Fatura nr.14-210-001-21 e datës 29.06.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbaram, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe nuk është e përshtatshme për përmbaram, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës dhe nuk mund të konstatohet se për çfarë lloj pune/shërbimi është kërkuar përmbushja e detyrimit nga debitori.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi pasi që me propozimin për përmbaram kreditori ka kërkuar përmbushjen e borxhit në shumën prej 453,220.20 €, mirëpo tek përshkrimi figuron vetëm “Tregu i ri i Qytetit”, ndërsa nuk është përshkruar se për cilat punë ose shërbime është lëshuar e njëjta dhe si rrjedhojë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Për më tepër vet përfaqësuesi i kreditorit gjatë seancës dëgjimore ka pohuar se punët për të cilat është faturuar debitori nuk janë kryer dhe se kontrata sipas së cilës është lëshuar fatura nuk ka filluar të zbatohet, mirëpo sipas nenit 30 të kontratës është përcaktuar se: *“nëse autoriteti kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë në vend ndërtim konsiderohet si shkak për kompensim”* dhe mbi këtë bazë të njëjtit kanë lëshuar faturën nr.14210-001 të datës 29.06.2021.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbaram, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbaramin nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat duhet të anulohet.

Ndërsa sa i përket kërkesave për kompensimin e dëmit apo vërtetimin e ekzistimit të tij, gjykata konstaton se të njëjtat nuk mund të trajtohen në procedurë përmbarimore, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarami, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarami, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1017/22, datë 29.08.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.